



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
BORDI

VENDIM

Nr. 46, datë 18.03.2020

MBI

**RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “ALBANIAN ENERGY SUPPLIER”
SH.P.K., NR. 277, SERIA FK15, NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË,
TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 38,
DATË 18.03.2015.**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37 pika 2, gërma “ç” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “d”; 5 pika 1 gërma “d”, nenit 13 dhe nenit 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s Nr. 109, datë 29.06.2016 e ndryshuar dhe nenit 15 të Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96 datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.03.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Licensimit, Mbikqyrjes dhe Autorizimeve, me nr.40/3 Prot., datë 09.03.2020, lidhur me “Rinovimin e licencës së shoqërisë “ALBANIAN ENERGY SUPPLIER” sh.p.k, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin Nr. 17, datë 31.01.2020, filloi procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “ALBANIAN ENERGY SUPPLIER” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje u krye njoftimi në median e shkruar, me shkresën nr. 62/5 Prot, datë 01.02.2020, dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “ALBANIAN ENERGY SUPPLIER” sh.p.k..
- Me shkresën nr. 38/2 Prot., datë 04.02.2020, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.
- Në përgjigje të sa më sipër, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 38/3 Prot, datë 18.02.2020, shoqëria “ALBANIAN ENERGY SUPPLIER” sh.p.k. ka përcjellë dokumentacionin e munguar.
- Shoqëria “ALBANIAN ENERGY SUPPLIER” sh.p.k., ka aplikuar brenda afatit ligjor të nevojshëm për rinovimin e licencës.

- Nga analiza që i'u bë dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria "ALBANIAN ENERGY SUPPLIER" sh.p.k., në bazë të nenit 16 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike", e ndryshuar, rezulton si më poshtë:
 - Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat "a", "b" "c") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat "a", "b", "c", "d" dhe "e") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3 gërmat "a", "b", "c" dhe "d"), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7 gërmat "a", "b", "c", "d", "e" dhe "f", pika 4.7.1, gërmat "a", "b" dhe "c") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të rinovojë licencën e shoqërisë "ALBANIAN ENERGY SUPPLIER" sh.p.k., me nr. 277, Seria FK15, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Nr. 38, datë 18.03.2015, për një afat 5 – vjeçar, duke filluar nga data 19.03.2020 për një afat 5 vëcar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brënda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI